

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Hunaida Pasuli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.LL. nga fshati ... e Madhe, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. N.R. nga Lipjani, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.M., me objekt të padisë dëmshpërblim, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.230/2012, të datës 10.01.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **19.04.2019**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan C.nr.230/2012, i datës 10.01.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.230/2012, të datës 10.01.2014, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e precizuar të paditësit S.LL. nga fshati ..., ashtu që ka obliguar të paditurën Komuna e Lipjanit, që paditësit t'ia paguajë shumën prej 8.644,00 euro në emër të kompensimit të sipërfaqes prej 80 m2 të ngastrës kadastrale nr.717-9 në vendin e quajtur "Mali Potok" e evidentuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme ZK Lipjan, të uzurpuar me asfaltimin e rrugës nga e paditura, me kamatë si për mjetet e deponuara në bankë, pa afat mbi një vit duke filluar nga data 27.11.2013 e deri tek pagesa definitive, si dhe t'ia kompensojë shumën prej 994,72 euro në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm; ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka obliguar paditësin që pas realizimit të dëmshpërblimit në pikën I të këtij aktgjykimi, t'ia njoh të paditurës të drejtën e pronësisë në sipërfaqe prej 80 m2, të ngastrës kadastrale nr.717-9 në vendin e quajtur "Mali Potok" e evidentuar në certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme ... ZK Lipjan.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve esenciale, me propozim që Gjykata me aktgjykim ta aprovojë në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, ta prishë në tërësi aktgjykimin e atakuar dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe vendosje.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është **e pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 19.09.2012 në Gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensim të dëmit, me vlerë të kontestit 100 euro, me të cilën ka kërkuar që Gjykata t'ia aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të obligojë të paditurën t'ia kompensojë shumën prej 10,000 euro në emër të pjesës së paluajtshmërisë së uzurpuar P-71409044-00717-9 në vendin e quajtur "Mali Potok", në sipërfaqe prej 80 m² e regjistruar në certifikatën mbi të drejtat e pronësisë së paluajtshme ... ZK, Lipjan, dhe t'ia kompensojë edhe shpenzimet e procedurës sa të arrijnë ato sipas llogarisë përfundimtare. Po ashtu, ka deklaruar se paditësi do t'ia njohë të paditurës të drejtën e pronësisë në këtë pjesë të paluajtshmërisë kur ky i fundit të përmbushë obligimin lidhur me kompensimin e dëmit real.

E paditura me datë 02.10.2013 ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve dhe ka kërkuar nga Gjykata që paditësit t'ia refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si në vijim: procesverbali i datës 01.11.2013 për nxjerrje të provës me dalje të Gjykatës në vend me ekspert të gjeodezisë, ekspertiza nga lëmia e gjeodezisë e hartuar nga gjeodeti A.C., certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71409044-02645 ZK Lipjan, ekspertiza financiare e datës 27.11.2013 e hartuar nga eksperti gjyqësor A.G. ecc. i diplomuar, aktgjykimi në bazë të pranimit të kësaj Gjykate C.nr.103/86 i datës 16.04.1986 i procesverbalit të dëgjimit të palëve 09.nr.1177-463 i datës 20.05.1983 dhe nr.09 nr.1175-463 të të paditurës të regjistrit me emra të disa qytetarëve në mesin e të cilëve është edhe emri i pronarit të mëparshëm të paluajtshmërisë kontestuese, si dhe pas vlerësimit të këtyre provave dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.230/2012, të datës 10.01.2014, me të cilën e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, Gjykata ka theksuar se nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71409044-02645 ZK Lipjan e lëshuar me 08.04.2010 rezulton se ngastra kadastrale P-71409044-00717-9, në vendin e quajtur "Mali Potok", shfrytëzimi aktual tokë e ndërtimit, në sipërfaqe prej 480 m², është e regjistruar në emër të paditësit S.LL., nga fshati ... e Madhe. Nga aktgjykimi në bazë të pranimit të kësaj Gjykate C.nr.103/86 i datës 16.04.1986, vërtetohet se paditësi S.LL. ngastrën kadastrale nr.717/9 në vendin e quajtur "Mali Potok" me kulturë, rrugë dhe arë në sipërfaqe prej 0.04,80 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr.929 ZK Lipjan, e ka blerë nga shitësi – ish pronari Millovanoviq R.B. nga fshati Gushtericë e Ulët. Nga ekspertiza e hartuar nga eksperti gjyqësor nga lëmia e gjeodezisë, A.C., vërtetohet se me asfaltim të kësaj rruge të lagjes, e cila shtrihet pranë ngastrës kadastrale kontestuese, në anën veriore të saj i është marrë sipërfaqja prej 80 m² për asfaltim të rrugës së lagjes. Gjykata konsideron se obligimi i të paditurës për

kompensim të dëmit të shkaktuar rrjedhë nga nenet 154, 172 dhe 185 të LMD-së. Lartësinë e aprovuar Gjykata e ka mbështetur në ekspertizën e hartuar nga eksperti gjyqësor Ali Gashi, vendimin mbi kamatën vonuese e bazoi në nenin 277 të LMD-së dhe nenin 3 të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në dispozitën 452 paragrafin 1 dhe 2 të LPK-së. Konform nenit 143 të LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Sa i përket obligimit të paditësit që pas realizimit të dëmshpërblimit t'ia njohë të paditurës të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale nr.717-9, në sipërfaqe prej 80 m², në vendin e quajtur "Mali Potok", Gjykata e ka mbështetur vendimin në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL71409044-02645 ZK Lipjan.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 i LPK-së, lidhur me nenin 182.2, pika n), pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të nenit 183 të LPK-së. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat materiale të paraqitura nga palët ndërgjyqëse dhe duke u bazuar në këto prova, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit e pranon në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë për mënyrën e vendosjes, pasi që kjo e fundit me të drejtë ka konstatuar se pala e paditur nuk ka dorëzuar ndonjë provë materiale e cila do të provonte faktin se është udhëhequr ndonjë procedurë për shpronësim të sipërfaqes së ngastrës kadastrale kontestuese, se e paditura ndonjëherë ia ka kompensuar paluajtshmërinë kontestuese paditësit apo pronarit të mëparshëm të kësaj paluajtshmërie, se paditësi ose pronari i mëparshëm kanë nënshkruar ndonjë deklaratë me të cilën janë pajtuar

që sipërfaqen e ngastrës kadastrale kontestuese t'ia dhurojnë të paditurës me qëllim të zgjerimit të asaj rruge lokale dhe asfaltimit të saj.

Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjen në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur së gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale. Në këtë drejtim, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura Komuna e Lipjanit, ta kompensoj dëmin, për marrjen e pronës paditësit pa bazë ligjore, gjënë mbështetje në nenin 1, 2 paragraf 1, 3 paragraf 1 dhe 2 dhe 8 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, ligj i aplikueshëm në Kosovë në kohën e krijimit të raportit juridik (të njëjtën e parashohin edhe dispozitat ligjore të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore që tani është në fuqi), neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Protokolli 1 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, i cili në nenin 1 thotë: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 1, 2 paragraf 1, 3 paragraf 1 dhe 2 dhe neni 8 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore. Kjo për faktin e drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut dhe si e tillë gëzon mbrojtje juridike dhe se të sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastral vlen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të cilit është regjistruar, ndërsa në këtë rast këtë të drejtë e ka argumentuar pala paditëse e jo e paditura, për arsye se në momentin e ndërtimit të rrugës kanë qenë në dijeni se po ndërtojnë rrugë në tokën e huaj, pa respektuar asnjë procedurë të paraparë me ligj, që do të ishte shpronësimi etj, e në kundërshtim të plotë me dispozitat e cekura me lartë e veçanërisht me neni 8, të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, me të cilin përcaktohet se: *“ e drejta e pronësisë mund të merret ose kufizohet vetëm në kushtet e përcaktuara me ligje, në pajtim me kushtetutën ”*. Në këtë drejtim, neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: *“E drejta e pronës është e garantuar, shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligje, në pajtim me interesin publik, askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona, Republika e Kosovës ose Autoriteti Publik i Republikës së Kosovës, mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohet”*.

Gjykata e Apelit e vlerësoi si të pabazuar pretendimin ankimor të së paditurës se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të neneve 376 dhe 379 të LMD-së lidhur me llogaritjen e afatit të parashkrimit e kërkesëpadisë së paditësit, sepse në rastin konkret rruga

është asfaltuar në vitin 2009/10 ndërsa padia është ngritur me 19.09.2012, çka do të thotë nuk ka kaluar afati subjektiv për parashkrim të kërkesës së paditësit siç parashihet në nenin 376 të LMD-së *“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi. Kërkesa e shpërblimit të dëmit të krijuar nga cenimi i detyrimit kontraktues parashkruhet për kohën e caktuar për parashkrimin e këtij detyrimi”*. Në këtë rast paditësit kompensimi i pasurisë së paluajtshme nuk ju ka caktuar as me ujdi pranë organit administrativ e as me vendim të gjykatës, pra në këtë rast paditësit, pasuria e tij e paluajtshme e cila akoma është e regjistruar si pronë e tij, pranë organeve kompetente, ju ka marr pa procedurë të paraparë me ligj, në mënyre arbitrare duke ja pamundësuar shfrytëzimin e saj dhe në këtë rast nuk ka mundur as të filloj afati i parashkrimit të kërkesës për kompensimin e pronës, sipas dispozitave të LMD-së. Kjo edhe për faktin se paditësi në këtë rast nuk kërkon kompensimin e dëmit apo fitimin e humbur për mos shfrytëzimin e pronës së tij, por kërkon kompensimin - kundërvlerën e pronës së tij e cila pronë ju ka marr në mënyre arbitrare dhe pa procedurë të paraparë me ligj, mbi të cilën pronë është ndërtuar rruga e asfaltuar e qe bie nën përgjegjësin dhe menaxhimin e të paditurës Komuna e Lipjanit. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se kërkesëpadia e paditësit në kuptim të dispozitave të lartë cekura nuk është parashkruar.

Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së, ndërsa vendimi mbi kamtatën është në përputhje me nenin 277 të LMD-së.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palës së paditur, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura, Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e) e lidhur me nenin 200 dhe 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1020/14, datë 19.04.2019

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka